



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 349 Prot

Datë 24/07/2018

VENDIM


Nr. 54 , Datë 17.07.2018

**“PËR
MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE SHKOLLIMIT PËR
PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE NË NJË
PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË FUSHËN E
DREJTËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 49, pika 1/a, ë dhe pika 4, Vendimit nr.25 datë 06.07.2018 të Senatit Akademik “Për miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2018-2019”, Bordi i Administrimit :

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2018-2019.
2. Pika 6 e tabelës bashkalidhur Vendimit nr. 25 datë 06.07.2018, Fakulteti i Drejtësisë , lloji i programit mbetet sipas tabelës që shoqëron relacionin e hartuar nga Administratori i UT-së , pra Drejtësi Cikli i Parë dhe jo Program i Integruar.
3. Ky Vendim i njoftohet Kryetarit të Senatit Akademik, Prof. Doc. Mynyr Koni dhe Administratorit të UT-së Z.Skerdi Dafa.
4. Ngarkohet Administratori UT-së për njoftimin e Vendimit strukturave përgjegjëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .


KRYETARË
PROF. AS. ADELA KARAPICI